

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6588
E mërkurë, 20 prill 2022
çmimi 0.40 €

“Ndërmarrje e Përbashkët
Kriminale” apo luftë
çlirimtare e Kosovës? | FAQE 3

Shkruan:
Kudusi LAMA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCËN PLENARE TË RADHËS | FAQE 4-5

DËSHTON FORMIMI I KOMISIONIT HETIMOR PËR ENERGIJINË, OPOZITA PARALAJMËRON BOJKOT



Deputetët e partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në seancën e së martës në Kuvend kanë kërkuar që të votohet mocioni procedural, në të cilin në rend dite ishte pika e formimit të komisionit parlamentar për energjinë, por ky mocion nuk ka marrë votat e mjaftueshme. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk kanë marrë pjesë në votim dhe menjëherë pas kësaj situatë partitë opozitare e kanë lëshuar sallën dhe kanë njoftuar se nuk do të votojnë për ligjet e tjera derisa kjo pikë të votohet

**Nxënësit
protestojnë
me moton
“S’po shkohet
në shkollë”** | FAQE 7



**U PEZULLOHET LEJA E IMPORTIT
KATËR KOMPANIVE TË DERIVATEVE
TË NAFTËS NË KOSOVË**

| FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



CLARKU VJEN NË KOSOVË F. 5

**PROCESI I NEGOCIATAVE
'NDËRLIKOHET' MË SHUMË NGA
RRETHIMI I MARIUPOLIT** F. 2

**MIRATOHEN TRI PROJEKTLIGJE NË
KUADËR TË REFORMËS NË
DREJTËSINË PENALE** F. 5

EKONOMI



**KOSOVA ME VETURA TË VJETRA,
IMPORTI I TYRE ËSHTË RRETH 10
VJET MË I VJETËR SE NË BE** F. 8

**DISKUTOHET PËR HARTIMIN E NISMËS
LEGJISLATIVE “PROJEKTLIGJI PËR
KRIPTOVALUTA”** F. 8

SPORT



**SOT GJYSMËFINALET E FINAL
4 TË LIGËS UNIKE** F. 10



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

RRUGA "PASHKO VASA", P.N. PRISHTINË, KOSOVË
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Procesi i negociatave 'ndërlkohet' më shumë nga rrethimi i Mariupolit



MARIUPOL, 19 PRILL - Rrethimi rus i qytetit të Mariupolit ka komplikuar më tej procesin e negociatave për luftën në Ukrainë dhe është e vështirë të thuhet se kur mund të rifillojnë bisedimet e drejtpërdrejta, tha të martën për "Reuters", negociatori ukrainas Mykhailo Podolyak. Podolyak tha në një përgjigje me shkrim për "Reuters"-in se ai besonte se Rusia po punonte për t'i forcuar pozicionet e saj përmes një ofensive të re që ka nisur në Ukrainën lindore. "Natyrshisht, në sfondin e tragjedisë së Mariupolit, procesi i negociatave është bërë edhe më i ndërlkohuar", tha ai. Rusia të martën u bëri thirrje forcave ukrainase që "menjëherë" t'i dorëzojnë armët

dhe lëshoi një ultimatum të ri që mbrojtësit e qytetit-port të rrethuar të Mariupolit që të heqin dorë. Paralajmërimi i Ministrisë ruse të Mbrojtjes u bë pasi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky njoftoi të hënën vonë për fillimin e një ofensive të re nga Moska që është e përqendruar në lindje të shtetit ish-sovjetik. "Ne u bëjmë thirrje edhe një herë autoriteteve të Kievit që të tregojnë arsye dhe të japin urdhrat përkatëse për luftëtarët që ta ndalojnë rezistencën e tyre të pakuptimtë. Por, duke kuptuar se ata nuk do të marrin udhëzime dhe urdhra të tilla nga autoritetet e Kievit, ne u bëjmë thirrje (luftëtarëve) që vullnetarisht ta marrin këtë vendim dhe t'i dorëzojnë armët",

ka njoftuar Ministria ruse e Mbrojtjes. Deklarata nuk përmendi drejtpërdrejt një ofensivë të re tokësore në Ukrainën lindore. Por, ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, konfirmoi se forcat e tij po "zbatonin gradualisht planin tonë për ta çliruar" Ukrainën lindore. "Ne po marrim masa për ta rivendosur jetën paqësore", tha ai në një takim televiziv me komandantët ushtarakë rusë. Disa nga luftimet më të ashpra të fushatës ruse janë përqendruar rreth qytetit-port të Mariupolit. Ndryshe, porti i Mariupolit ofron një urë tokësore midis pjesëve të kontrolluara nga Moska të Ukrainës lindore dhe Gadishullit të Krimesë të aneksuar nga Kremli.

Greçia sekuestron cisternën ruse si pjesë e sanksioneve të BE-së për Ukrainën

ATHINË, 19 PRILL - Autoritetet greke thonë se kanë sekuestruar një cisternë ruse në Detin Egje si pjesë e sanksioneve të Bashkimit Evropian të vendosura kundër Rusisë për pushtimin e saj të paprovokuar të Ukrainës. Anija ruse, me 19 anëtarë rusë të ekuipazhit në bord, u sekuestrua më 19 prill pranë qytetit bregdetar të Karystos në bregun

jugor të ishullit Evia. "Ajo është sekuestruar si pjesë e sanksioneve të BE-së", tha një zyrtar i Ministrisë së Transportit. Roja bregdetare tha se urdhri i konfiskimit kishte të bënte me anijen dhe jo me ngarkesën e saj. Anija kishte pasur probleme mekanike dhe po shoqërohej me një rimorkiator në Peloponez, në mënyrë që ngarkesa e saj të transferohej në një anije tjetër.

Megjithatë, deti i trazuar e detyroi atë të ndalej në Karystos. Bashkimi Evropian, anëtarë e të cilit është Greçia, ka miratuar një sërë sanksionesh kundër Moskës për pushtimin e saj të paprovokuar të Ukrainës. Sanksionet përfshijnë ndalimin e importit dhe eksportit për një gamë të gjerë mallrash dhe ndalimin e hyrjes në portet e BE-së nga anijet me flamur rus.



Shangai raporton për shtatë të vdekur nga koronavirusi



SHANGAI, 19 PRILL - Kina ka raportuar për shtatë të vdekur nga koronavirusi në Shangai më 19 prill, pas raportimit për qindra mijëra raste të infektimit, ndonëse qyteti është në izolim. Sipas autoriteteve, në dy ditët e fundit është raportuar për 10 të vdekur. Pekini insiston në politikën për zero raste me koronavirus dhe

masa të ashpra izolimi, testimet masive dhe karantina të gjata. Në disa postime të paverifikuara në rrjetet sociale është pretenduar se vdekjet në Shangai nuk janë duke u raportuar. Zyrtarët shëndetësorë në Shangai kanë thënë që më pak se dy të tretat e banorëve mbi 60 vjeç kanë marrë dy vaksina për koronavirus dhe më pak se 40

për qind kanë marrë dozën përforcuese. Në shtatë rastet e fundit të vdekjeve viktimat kanë qenë të pavaksinuar, kanë thënë autoritetet e qytetit. Më shumë se 25 milionë banorë të Shangait janë izoluar nëpër shtëpitë e tyre prej muajit mars. Shumë prej tyre janë ankuar nëpër rrjetet sociale se kanë pak rezerva të ushqimit.

Rusia dëbon diplomatë nga Belgjika e Holanda

MOSKË, 19 PRILL - Rusia ka njoftuar të martën për dëbimin e 38 diplomatëve nga dy shtete të Bashkimit Evropian, në kundërpërgjigje të hapave të ngjashëm të ndërmarrë ndaj diplomatëve rusë për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Kremli. Ministria e Jashtme ruse përmes një deklarate ka

shpallur 21 diplomatë nga Belgjika dhe 15 nga Holanda si "persona non grata" (persona të padëshiruar), dhe u ka dhënë dy javë afat që të largohen nga shteti. Ministria, po ashtu, tha se ka thirrur në bisedë ambasadorin e Luksemburgut në Moskë për ta paralajmëruar atë se Rusia mund të marrë vendim për masa reciproke, pasi ky shtet

evropian së fundmi ka dëbuar diplomatë rusë. Shtetet evropiane kanë dëbuar mbi 300 diplomatë rusë qëkur Moska nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Rusia është kundërpërgjigjur javën e fundit duke dëbuar diplomatë të Republikës Çeke, Bullgarisë dhe të Bashkimit Evropian, si dhe diplomatë belgë dhe holandezë.



“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” apo luftë çlirimtare e Kosovës?



Shkruan: Kudusi LAMA

1. Kjo është një pyetje që kërkon përgjigje:

a. prej gjithë qytetarëve të Kosovës, - të cilët sot gëzojnë lirinë, nuk janë të detyruar të mos guxojnë të tregojnë se janë shqiptarë. Qytetarët e Kosovës, janë pjesë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata mund të konsiderohen me shumë të drejtë dhe bindje të pa lëkundshme luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kështu që për mua Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pasur 2 milionë luftëtarë. Të gjithë kanë qenë nën pushtim. Të gjithë kanë qenë nën rrezikun dhe kërcënimin e ekzekutimit. Të gjithë kanë qenë në kufijtë e fundit të ekzistencës ose mosekzistencës. Prandaj edhe të gjithë e kanë për detyrë të jenë një trup monolit përballë çdo tentative për të na e helmuar historinë e për të na e përdhunuar luftën çlirimtare të Kosovës dhe ushtrinë që e barti atë luftë.

b. prej të gjithë intelektualëve e shkencëtarëve të Kosovës, - që të argumentojnë me bindje padrejtësinë që po bëhet ndaj historisë tonë më të re. Asaj historie që na dha frymëmarrjen, që na dha jetën, që na dha mundësinë të jemi, që na dha identitetin dhe integritetin. Ta marrin në mbrojtje Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën e saj. Jo vetëm pse është jona por se është histori e pastër si loti. Po lejuam që të na nëpërkëmbet historia e luftës dhe ushtria që e barti atë luftë, jam i sigurt se kurrë nuk do të jemi intelektualë me integritet dhe me vlera. Pa vlerësuar e dashur veten nuk mund të duash familjen; pa dashur familjen nuk mund të duash atdheun e kombin; pa dashur atdheun e kombin nuk mund të duash shoqërinë; pa

dashur shoqërinë nuk mund të jesh i barabartë me të tjerët. Duhet të jemi të barabartë midis të barabartëve. Por kjo arrihet nëse mbrojmë nga goditjet historinë tonë. Ky është misioni i inteligjencies së një vendi a kombi e në rastin tonë i inteligjencies së Kosovës.

c. prej të gjithë politikanëve e politikëbërësve të Kosovës, të cilët nuk mund të jenë me dinjitet përpara botës duke zhvlerësuar ose mohuar a përbuzur dhe akuzuar historinë e vendit të tyre në marrëdhënie me politikanët e politikëbërësit e Evropës a të botës, që ta përkrahin luftën e popullit të tyre për liri. Ata duhet të jenë krenarë për luftën çlirimtare të Kosovës, për ushtrinë që e barti atë luftë vigane, për luftëtarët të cilët e përbënë atë ushtri që na dha lirinë, për invalidët që dhanë pjesët e trupit për ta bërë lirinë, për dëshmorët që u ngjitën në pedestal për t'u bërë modeli i luftëtarëve të lirisë dhe për të qëndruar aty në rojet të fitoreve të arritura si garant të përjetshëm.

ç. prej të gjithë qeveritarëve të qeverisjes qendrore e vendore të Kosovës, - që ta duan më shumë atdheun, siç e deshën luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E të duash atdheun do të thotë të nderosh historinë e fitoreve të tij, të mos lejosh që fitoret e atdheut të nëpërkëmben nga askush, të ndihesh mirë nën rrobën e origjinës, të cilës i përket, dhe të jesh vlerësues i veprës së të tjerëve, para se të ndërtosh veprën tënde. Apeloj që qeveritarët të marrin seriozisht në dorë moslejimin e nëpërkëmbjes së historisë së luftës çlirimtare të Kosovës, të ushtrisë që e realizoi dhe të luftëtarëve, të cilët janë aty të gatshëm me ju për të çuar përpara arritjet e deritanishme

me gjak e me djersë.

d. prej Parlamentit të Kosovës, - që të mendojë me një zë, në unitet të plotë, se e ka për mision të tij ta thërrasë në raport këtë Prokurorinë e Gjykatës Speciale, për ta dëgjuar dhe për të kërkuar nga ajo t'i zbatojë ligjet për të cilat është krijuar. Ajo prokurori dhe gjykatë nuk ka të drejtë të veprojë jashtë kompetencave që i ka dhënë ai parlament.

e. prej Presidencës së Kosovës, - që fjalë të parë ta ketë mbrojtjen e historisë dhe të vlerave të trashëguara, me bindjen se vetëm kështu rritet autoriteti i shtetit dhe i kombit. Mbrojtja e luftëtarëve të lirisë dhe e qytetarëve të Kosovës është a-ja e autoritetit të një kryetari shteti.

ë. prej Qeverisë së Kosovës, - që të nderojë luftën çlirimtare, të nderojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, t'i nderojë e t'i dojë luftëtarët, t'i mbrojnë vlerat dhe të kërkojë që mos të na përbaltet historia qoftë edhe prej asaj gjykate që e ka pranuar e miratuar si gjykatë të saj, por që ka dalë jashtë kontrollit të ligjeve të Kosovës.

f. prej universiteteve publike e private të Kosovës, - që të ngrënë në këmbë opinionin e studentëve dhe profesorëve, të cilët në unitet të plotë të tregojnë se nuk janë dakord me përbaltjen e luftës çlirimtare të Kosovës dhe emërtimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”.

g. prej Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, - e cila e ka për detyrë të argumentojë nëse qëndron apo jo termi “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si historikisht, juridikisht etj.

gj. prej Institutit të Historisë së Kosovës, - i cili duhet të ndalet seriozisht dhe të kërkojë të

drejtat historike të luftës çlirimtare të Kosovës, duke hedhur poshtë - nëse duhen hedhur poshtë, të gjitha tentativat për të na e kriminalizuar luftën çlirimtare të Kosovës dhe ushtrinë që e barti atë.

h. prej Institutit Albanologjik të Prishtinës; - i cili duhet të ndërmarrë hapa për të tërhequr vëmendjen e instituteve homologe të gjithë Evropës e me tej, që të jap shpjegime shkencore për terminologjinë e përdorur për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”.

2. kërkon përgjigje prej të gjithë institucioneve ndërkombëtare si:

a. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), - që ta shpreh mendimin se si mund e duhet të vendoset drejtësia në vlerësimin e luftës çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë që e barti atë luftë.

b. prej NATO-s, - nëse ishte bashkëluftëtarë në rrugën për çlirimin e Kosovës me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, siç deklarohet në atë kohë luftime. Pra tani 23 vjet pas përfundimit të luftës, NATO-ja a mendon se ka qenë bashkëluftëtarë e një “ndërmarrje të përbashkët kriminale”?

c. prej Bashkimit Evropian; - nëse ishte bashkëpunëtor në rrugën për çlirimin e Kosovës me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, apo ishte bashkëpunëtor i një “ndërmarrje të përbashkët kriminale”?

3. kërkon përgjigje prej shteteve të zhvilluara si:

a. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, - a vërtetë do të lejojë që lufta çlirimtare e Kosovës të kriminalizohet,

Ushtria Çlirimtare e Kosovës të emërtohet “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”, si dhe luftëtarët të quhen kriminelë? Shpresoj të merret seriozisht. Shpresoj që SHBA-të të japin vlerësimin për këto çështje.

b. Gjermania, - të na thotë atë që është e pritshme prej Gjermanisë, si një shtet dhe komb i të drejtës dhe të vërtetës që e ka prezantuar veten nëpër histori. A vlerëson se Gjykata Speciale ka të drejtë në emërtimin që ka bërë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës? c. Franca, - vendi i kulturës, duhet ta thotë fjalën e saj politikisht dhe juridikisht, nëse beson se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”?

ç. Mbretëria e Bashkuar, - që njihet për ligjshmërinë dhe fuqinë e arsytimit ligjor, të thotë fjalën e saj, si dje kur u bë bashkëluftëtarë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bashkë me SHBA-të dhe vendet e tjera anëtare të NATO-s, ashtu edhe sot që po duan t'i kriminalizojnë veprimet që ka bërë në këtë

luftë, duke e emërtuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”.

A kanë fuqi këta përbërës qytetarë, shtetërorë, shoqërorë dhe ndërkombëtarë, për të dhënë përgjigje për pyetjen e mësipërme? A mund të thotë dikush se kur është mjaft? A mund të sqarohet dikush se cila është qytetaria që i duhet përgjigjur me qytetari? A mund të na tregojë dikush se cila quhet drejtësi? A mund të arsyetojë dikush nëse janë ose jo njerëzit të barabartë mbi tokë? A mund të na tregojë dikush se cila duhet të quhet e vërtetë? A mund të na tregojë dikush se kur duhen marrë armët për të luftuar armikun? A mund të na qartësojë dikush se kush quhet armik? A mund të saktësojë dikush se kur shteti duhet të mbrojtë qytetarët e tij? A mund të bëhet e qartë se deri ku e ka kufirin liria e fjalës dhe e mendimit? A mund të na saktësojë dikush, nëse kur dikush vret atë që i hynë në shtëpi për ta vrarë, a bën krim dhe ai a quhet kriminel? A mund të jepet përgjigje për pyetjen se cila është përgjegjësia individuale dhe cila është përgjegjësia kolektive për një krim që mund të kryhet nga një individ, sipas mendimit e vendimit të tij ose për qejfin e tij? A mund të bëjë dikush qartësimin a ka të drejtë Prokuroria të sillet me armiqësi me të arrestuarit gjatë procesit të hetimit dhe gjyqimit apo duhet të punojë me korrektësi e profesionalizëm? A mund të thotë dikush pse duhet t'i lejojë vetes gjykata, që të mos pranojë të flasë i gjeturi në bankën e të akuzuarit atë që ai dëshiron ta shpreh, por të tregojë mosdurim dhe ta ndërpresë fjalën e tij? A mund të qartësohet cila është e drejta që dëshmitarët të jenë të fshehur nga i akuzuari dhe dëshmia e tyre të merret si e vërtetë?

Vlerësoj se përgjigjet e drejta për këto pyetje, do të kishin qartësuar deri diku situatën që është krijuar në Kosovë dhe në opinionin evropian e botëror me instalimin e Gjykatës Speciale të Kosovës (Ndërkombëtare) për krimet e luftës të supozuara se janë bërë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Dhe që këtu, unë pranoj se aktualisht Gjykata Speciale në Hagë nuk e ka ngritur drejtë padinë. Ajo duhet - në radhë të parë të kishte paditur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për krimet e vetëkrijimit në një tokë të pushtuar nga Serbia dhe të prishjes së planeve serbe për tjetërsimin e trojeve të shqiptarëve, të cilin kanë filluar ta kryejnë që nga vitit 1832. Kështu që, kjo gjykatë duhet të kishte filluar nga ky akt akuzimi Serbia e pagoi Serbia Dick Marty-n. (Vijon)



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCËN PLENARE TË RADHËS

Dështon formimi i komisionit hetimor për energji, opozita paralajmëron bojkot

Deputetët e partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në seancën e së martës në Kuvend kërkuan që të votohet mocioni procedural, në të cilin në rend dite ishte pika e formimit të komisionit parlamentar për energji, por ky mocion nuk mori votat e duhura. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk morën pjesë fare në votim dhe menjëherë pas kësaj partitë opozitare e lëshuan sallën duke njoftuar se nuk do të votojnë për ligjet e tjera derisa kjo pikë të votohet

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 PRILL - Nuk ka kaluar mocioni procedural i propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për futjen në rend të ditës, në seancën e së martës, formimin e Komisionit hetimor parlamentar për krizën energjetike.

Prej 108 deputetëve të pranishëm në sallë, vetëm 33 prej tyre votuan pro këtij mocioni. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk morën pjesë fare në votim. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se ky mocion shtyhet për në seancën e radhës.

Menjëherë pas kësaj, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se nuk do të marrin pjesë më në seanca të radhës të Kuvendit deri në formimin e këtij komisioni. "Opozitës iu mohua një e drejtë kushtetuese. Grupi parlamentar i LDK-së deri në formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar nuk do të marrë pjesë në asnjë votim. Për këtë ne e lëshojmë seancën", ka thënë Gashi. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se PDK-

ja nuk do të marrë pjesë në asnjë votim deri në formimin e këtij komisioni.

Seancën e ka lëshuar edhe grupi parlamentar i AAK-së. "Është një gabim i pafalshëm mosvotimi i këtij komisioni. Jemi të detyruar ta lëshojmë sallën. Ky proces u bllokua pa kurrfarë nevojë", ka thënë shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri.

Pas kësaj situatë të tria subjektet politike kanë mbajtur konferenca për medie.

Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, i bëri thirrje opozitës që të reflektojë dhe të mos presë që kjo parti t'ua bëjë numrat në Kuvend për formimin e një komisioni hetimor për çështjen e energjisë.

Në një konferencë për medie, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se kërkesa e partive opozitare, që në seancën e sotme të votohej për themelimin e komisionit hetimor për periudhën kur qeveria shpalli gjendje emergjente për energji, ishte në kundërshtim me ligjin. "Sot ishte përpjekja e dytë e opozitës që në

kundërshtoi me rregullat për formimin e komisionit hetimor parlamentar tentoi të vendosë para aktit të kryer seancën plenare të Kuvendit. Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje refuzoi të bëhet pjesë e kësaj ndërmarrjeje që shkel mbi normat e ligjit për hetimin parlamentar", ka deklaruar Kusari-Lila.

Ajo ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje nuk ka asgjë për të fshehur në raport me kërkesat për hetim parlamentar për masat e marra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në sektorin e energjisë. "Megjithatë, ne nuk mund t'ia bëjmë numrat opozitës në këtë rrethanë, veçmas jo në situatën kur parashohim që të bëjnë shkelje në raport me normat ligjore e, gjithashtu, krahas tyre, t'i pranojmë etiketimet, fyerjet dhe paragjykimet që çdokush që është në pozitë sillt njëjtë sikurse dikur është sjellë opozita e sotme", është shprehur Kusari-Lila.

Në një konferencë tjetër për medie, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se është hera e parë në historinë parlamentare të Republikës së

Kosovës që pushteti i shumicës shkel të drejtën e pakontestueshme për hetim parlamentar, si një e drejtë kushtetuese për ta mbikëqyrur punën e qeverisë dhe institucioneve nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Kreu i opozitës ka thënë se bllokimi nga ana e shumicës parlamentare për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike është shkelje brutale e ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës nga mazhoranca dhe qeveria Kurti. "Kryeministri Kurti, përmes deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, për herë të dytë sot e bllokoi miratimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me krizën energjetike në vend, duke shkelur haptas ligjin dhe Kushtetutën, diçka që tashmë është bërë traditë dhe praktikë e kësaj qeverie. Por, përkundër këtij insistimi të këtij pushteti për ta mbajtur fshehtë krejt atë që ka ndodhur për muaj të tërë, sot ju themi se arroganca e numrave të pushtetit nuk mund ta ndalojë nxjerrjen në dritë të së vërtetës", ka thënë ai.

Krasniqi ka theksuar se është e evidente që qeveria Kurti po bën çdo përpjekje të mundshme për ta pamundësuar hetimin që e ka kërkuar Partia Demokratike e Kosovës, me mbështetjen e deputetëve të tjerë të opozitës. "Pyetja e parë që në këtë rast

përsëri imponohet dhe duhet të shtrohet është: çka janë duke fshehur nga opinioni publik që me kaq bindje po shkelin ligjin dhe Kushtetutën vetëm për ta pamundësuar nxjerrjen e së vërtetës në dritë? Çfarë shkeljesh e krimesh potenciale janë duke mbrojtur me këtë insistim kundër hetimit parlamentar? Pse kryeministri Kurti po e pengon hetimin e rastit të faljes së mbi 100 milionë eurove të taksave të qytetarëve për KEDS-in, hetimin e rritjes së paligjshme të tarifave të rrymës nga ZRRE, punësimet familjare dhe partiake në KEK, blerjen e rrymës me çmime më të larta se të tregut gjatë dimrit, shitjen e rrymës me çmime më të ulëta se të tregut e shumë shkelje e parregullsi të tjera? Nëse s'kanë çfarë të fshehin, qoftë personalisht dhe si grup, pjesë e veprave penale potenciale dhe aferave e keqpërdorimeve në KEK dhe në veprimet e tjera rreth krizës energjetike, atëherë pse po e bllokoni themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar?", ka pyetur Krasniqi.

Kryetari i PDK-së konsideron se kjo nuk është vetëm përpjekje për fshehje të së vërtetës, por edhe precedent i rrezikshëm ndaj demokracisë dhe sundimit të ligjit, andaj PDK-ja do të përdorë çdo mjet demokratik për ta zbardhur të vërtetën lidhur me keqpërdorimet e bëra në periudhën e krizës energjetike. →

Clarku vjen në Kosovë

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim ish-komandantin suprem të forcave aleate të NATO-s në Evropë gjatë viteve 1997-2000, gjeneralin Wesley K. Clark.

Në takimin e përbashkët me zëvendëskryeministren Emilija Rexhepi, ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe investitorë të huaj, u bisedua për zhvillimin e ekonomisë dhe reformat e nisura nga qeveria.

Gjenerali Clark e uroi kryeministrin për të arriturat e deritanishme dhe shprehu mbështetje për synimet e qeverisë.

Duke biseduar për angazhimin e qeverisë ndaj perspektivës së re të energjisë, u tha se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të punojë për diversifikimin e burimeve energjetike të vendit dhe për ruajtjen e sigurisë së furnizimit. Ministrja Rizvanolli foli për procesin drejt finalizimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2022-2031 dhe planit të veprimit, për një tranzicion të drejtë energjetik për vendin. U ritheksua angazhimi i qeverisë për të tërhequr investitorë që do të zhvillojnë kapacitete të reja energjetike që ofrojnë siguri të furnizimit.



Miratohen tri projektligje në kuadër të reformës në drejtësinë penale



PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Kuvendi i Kosovës të martën miratoi tri projektligje në lexim të parë: Projektligjin për

Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Projektligjin për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Projektligjin për

Shërbimin Sprovues të Kosovës. Në prezantimin e saj para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ministrja e Drejtësisë,

Albulena Haxhiu, ka theksuar rëndësinë dhe nevojën e avancimit të kornizës ligjore në thellimin e reformave në drejtësinë penale si pjesë të Strategjisë së Ministrisë së Drejtësisë për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Si risi në kuadër të projektligjeve ajo ka theksuar përcaktimin e Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë që u mundëson këtyre shërbimeve pavarësinë funksionale në fushëveprimin e tyre dhe krijimin e njëjësive të veçanta në funksion të realizimit të mandatit të tyre.

Ndërsa ministrja Haxhiu ka thënë se kjo reformë ligjore trajton dhe rregullon edhe disa çështje të ekzekutimit të sanksioneve penale që janë karakterizuar me sfida në zbatimin e tyre si dhe mungesë

të rregullimit të disa të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, që i kontribuojnë rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre më të lehtë në shoqëri.

Ndër risitë e tjera në kuadër të Projektligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ajo përmendi: mundësinë e apelimit të vendimit për lirim me kusht nga personat e dënuar në një shkallë të dytë gjyqësore; përshkallëzimin e lirimit të parakohshëm nga tre, gjashtë, respektivisht nëntë muaj para përfundimit të dënimit; zgjerimin e pezullimit të dënimit edhe për sëmundjet e rënda për personat e dënuar, deri në shërimin e tyre të plotë; rikthimin e ditëve të pushimit vjetor për personat e dënuar që punojnë etj. Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës miratuan me shumicë votash në parim të tri projektligjet e sipërpërmendura.

Edhe kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka akuzuar qeverinë se ka penguar Kuvendin që të votojë për themelimin e komisionit hetimor që, sipas tij, ka për qëllim t'i hetojë shpenzimet dhe subvencionet për sektorin e energjisë. Ai ka thënë se grupi parlamentar i AAK-së nuk do të marrë pjesë në asnjë votim në

Kuvend derisa të miratohet ky komision. "Edhe pse vendi ka hyrë në një krizë të thellë ekonomike, sot të gjithë jemi dëshmitarë se ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte. Qeveria e pengoi themelimin e komisionit hetimor parlamentar për shpenzimet në subvencionimin e sektorit të energjisë. Për këto arsye dhe shumë të tjera, grupi

parlamentar i AAK-së nuk do të marrë pjesë në asnjë votim deri në themelimin e këtij komisioni", u shpreh i pari i AAK-së para gazetarëve.

Kuvendi i Kosovës më 29 dhjetor të vitit 2021 kishte miratuar masat emergjente të Qeverisë së Kosovës lidhur me furnizimin e energjisë elektrike. Këto masa përfshinin:

vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

Për shkak të mungesës me furnizim me energji dhe rritjes së çmimeve të importit për energjinë, Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike (ZRRE) prezantoi tarifën me rritje dhe Qeveria e Kosovës u zotua se do

t'i subvenciononte me 90 milionë euro konsumatorët që shpenzojnë mbi 800 kilovatë energji elektrike. Megjithatë, në fillim të prillit Gjykata Themelore e Prishtinës ka pezulluar vendimin për shtrenjtimin e rrymës, duke vendosur masë të parakohshme deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për këtë çështje.

Muhaxheri kërkon nga operatorët ekonomikë të fillojnë punët e kontraktuara të projekteve

Pejë, 19 prill (ER) - Kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka udhëhequr takimin konsultativ të Këshillit të Drejtorëve, ku është diskutuar për disa tema me rëndësi për këtë komunë. Në këtë takim Muhaxheri ka kërkuar nga drejtorët e drejtorive që me shpresa zyrtare të kërkohet nga

operatorët ekonomikë që t'i fillojnë punët e kontraktuara të projekteve që janë të papërfunduara.

Zyrtarë të Drejtorisë së Inspeksionit kanë theksuar se janë duke bërë inspektimet e rregullta, sidomos në lokalet e natës dhe në tregjet ilegale dhe te shitësit ambulativ nëpër rrugë dhe sheshe.

Nga Drejtoria e Arsimit u njoftua se këtë vit Peja do të jetë nikoqire e Festës Kombëtare të Abetares dhe është kërkuar bashkëpunim me drejtoritë që organizimi të jetë sa më i mirë. Po në këtë takim pati edhe prezantime të tjera për punët dhe obligimet e përditshme nga drejtorët e pranishëm.



Mbahet takim informues me asamblistë për hartën zonale në Podujevë

PODUJEVË, 19 PRILL (ER) - Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje e Mjedisit, pasi ka marrë pëlqimin për hartën zonale të Podujevës 2022-2030 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, ka organizuar takim informues me asamblistët e Kuvendit Komunal, në të cilën kanë marrë pjesë edhe kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, nënkryetari Marigona Lahu dhe drejtorë të drejtorive.

Të pranishmit në detaje për hartën zonale i ka informuar drejtori i Planifikimit Urban dhe Mbrojtje e Mjedisit, Leutrim Krasniqi, i cili ka elaboruar në tërësi hartën zonale, për të cilën ka thënë se është dokument

multisektorial që përcakton llojin, destinimin dhe shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës publike dhe private në territorin e komunës së Podujevës për një periudhë tetëvjeçare.

Ndërsa kryetari Bulliqi ka potencuar se harta zonale përcakton kushtet zhvillimore dhe ndërtimore, duke u bërë thirrje të gjithë asamblistëve ta mbështetnin këtë proces dokument, për të cilin ka thënë se rëndësia e tij është e domosdoshme për planifikimin hapësinor dhe zhvillimin komunal të komunës së Podujevës. Propozimvendimi për miratimin e hartës zonale të komunës së Podujevës pritet të mbahet më 29 prill.



Komuna e Skenderajt përkujton Idriz Rrecajn dhe Demir Ahmetin

SKENDERAJ, 19 PRILL (ER) - Me nderime të larta institucionale është përkujtuar të martën Idriz Rrecaj, një ndër veprimtarët e shquar të çështjes shqiptare të Kosovës dhe intelektual i kohës, i cili është zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Me këtë rast janë bërë homazhe te pllaka e parkut publik që mban emrin e tij, nga kryetari i komunës, Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu, familjarët, drejtorët komunalë, asamblistë, bashkëluftëtarë të UÇK-së, udhëheqës të shoqatave të dala

nga lufta dhe qytetarë të shumtë. Nënkryetari Lushtaku, në fjalimin e tij para të pranishmëve, ka thënë se Idriz Rrecaj ishte prej burrave të mëdhenj që pa ndalur kanë vepruar në shërbim të lirisë. "Fillimisht i priu elitës politike në Drenicë e cila kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes shoqërore për liri e pastaj, kur ndërruan rrethanat, përkrahu fuqishëm luftën e UÇK-së. Për mua, por dhe për shumë të tjerë, Idrizi de fakto ishte kryetar i Skenderajt në vitet 1990 dhe referencë e fuqishme intelektuale dhe patriotike në këtë pjesë", ka thënë nënkryetari Lushtaku.

Të martën është përkujtuar me homazhe te pllaka përkujtimore në oborrin e Shkollës së Mesme Teknike "Anton Çetta", edhe heroi Demir Ahmeti, i zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë, për ta lënë pas pritjen dhe dëshpërimin e vazhdueshëm për mungesën e zbardhjes së fatit të tij.

Kryetari Nura, pasi është përshëndetur me familjarët, ka thënë se Demiri i vogël, që e ka trashëguar emrin, kur të rritet do të mësojë se gjyshi i tij ka dhënë një kontribut të çmuar për lirinë që ai dhe bashkëmoshatarët e tij po e gëzojnë.

Vazhdon lirimi i hapësirave publike në Mitrovicë

MITROVICË, 19 PRILL (ER) - Drejtoria e Inspeksionit e komunës së Mitrovicës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë vazhduar aksionin për lirimin e hapësirave publike. Inspektorët komunalë, në kuadër të planit të punës, edhe përgjatë fundjavës kanë iniciuar

aksione për rrënimin e ndërtimeve pa leje në lagjen "Iliridë", respektivisht në rrugën "Bajram Curri" në Mitrovicë. Me këtë rast, drejtori i Inspeksionit, Valon Brahim, ka theksuar se aksionet e tilla, të cilat kanë për qëllim lirimin e hapësirave publike, do të vazhdojnë edhe në të

ardhmen. "Si Drejtori e Inspeksionit vlerësojmë se mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i qytetarëve është shumë i rëndësishëm, njëkohësisht bëjmë thirrje të të gjithë qytetarët dhe subjektet afariste që t'i respektojnë dispozitat e ligjeve në fuqi", ka thënë Brahim.



447 raste aktive me Covid në Kosovë

Prishtinë, 19 prill (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 837 testeve, 3 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është

shënuar asnjë rast i vdekjes. Të martën janë shëruar 28 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 295. Në total numri i rasteve aktive është 447.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 54 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 824 629 doza të vaksinës. Deri më

sot 821 459 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Po ashtu, deri më sot janë dhënë 100 926 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Konjufca bëri nderime në Hallaq dhe Makoc: Dëshmorët dhe martirët, gurthemet e lirisë

LIPJAN, 19 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në 23-vjetorin e masakrës në fshatin Hallaq të Lipjanit, ka përkujtuar martirët, duke vendosur kurora me lule në memorialin e të rënëve të këtij fshati.

Duke çmuar lart sakrificën sublime të të rënëve të kësaj ane, si dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Konjufca u shpreh se në përvjetorët e

këtyre masakrave, dhimbja dhe pikëllimi i familjarëve vetëm sa shtohet.

Megjithatë, sipas kryetarit Konjufca, sakrificat e bërë për liri është akti më i lartë i atdheadashurisë, ndaj edhe krenaria është baras me dhimbjen. “Dëshmorët dhe martirët i dhanë Kosovës më të shtrenjtën e tyre - jetën, dhe gjaku i tyre është gurthemel i lirisë dhe shtetit tonë të pavarur.

Nderimi, respekti dhe kujtimi për të rënë do të jetë i përgjithmonshëm”, ka thënë Konjufca.

Në vazhdim të nderimeve të martirëve dhe dëshmorëve, kryeparlamentari Konjufca bëri homazhe para lapidarit të të rënëve në fshatin Makoc të komunës së Prishtinës. Ai vendosi kurora lule duke çmuar sakrificën e secilit që dha jetën për liri.



Qeveria premton se do të fokusohet në zhvillimin e bizneseve turke në Kosovë

“Epoka e re”

PRISHTINË, 19 PRILL - Në prag të Ditës së Turqve të Kosovës, kryeministri Albin Kurti ka bashkëbiseduar të martën me përfaqësuesit e komunitetit turk në Kosovë për sfidat dhe mundësitë e këtij komuniteti.

Në tryezën e organizuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, Kurti ndau me përfaqësuesit e komunitetit turk disa prej hapave të cilët qeveria i ka ndërmarrë për përmirësimin e mirëqenies së këtij komuniteti.

Angazhimi në punë i praktikantëve nga komunitetet, përfshirë atë turk përmes konkursit të

hapur nga Zyra për Çështje të Komuniteteve dhe grantet që ofrohen nga Zyra për Çështje të Komuniteteve, u vlerësuan si praktika të mira.

Në këtë takim u theksua se vlerësimi i aplikimeve në thirrjen e parë publike për aktivitete kulturore është në proces nga komisioni i pavarur, ndërsa dy thirrje të tjera do të hapen gjatë këtij muaji dhe gjatë verës. 1.5 milion euro do të ndahen për këto grante dhe do t'u jepet prioritet iniciativave ku përfaqësohen gratë dhe rinia.

“Zhvillimi i bizneseve turke dhe krijimi i më shumë vendeve të punës përmes granteve që ofrohen nga Zyra për Çështjet e Komuniteteve është një praktikë



e mirë. Kemi filluar me një proces transparent dhe fer për ndarjen e këtyre granteve, shumë më ndryshe nga ç'jemi mësuar, me fonde të rezervuara për secilin komunitet”, ka deklaruar Kurti.

Fuqizimi i rolit të zyrave komu-

nale për komunitete dhe kthim u veçua nga kryeministri si hallkë kyçe për adresimin e sfidave, vështirësive, nevojave të jetës së përditshme të qytetarëve. “Duke e ditur rëndësinë e mesimit në gjuhën e juaj, qeveria jonë ka

marrë vendim për pagesë të autorëve në mënyrë që tekstet shkollore në gjuhën turke të jenë në dispozicion për nxënësit tanë nga ky komunitet”, ka thënë kryeministri Kurti.

Duke diskutuar për përdorimin e gjuhës turke si një prej sfidave kryesore, u tha se Zyra e Komisionarit të Gjuhës po punon në rastet që janë ngritur ku është evidentuar mohimi i të drejtës së qytetarëve turk për përdorimin e gjuhës së tyre në nivel komunal. Ndër mundësitë kryesoret u theksua rritja e bizneseve turke. Kryeministri Kurti ka theksuar angazhimin për promovimin e këtyre bizneseve si kontribuues të një të ardhme të suksesshme për vendin tonë.

U pezullohet leja e importit katër kompanive të derivateve të naftës në Kosovë



PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka revokuar dhe pezulluar lejet për katër kompani të derivateve të naftës në Kosovë.

Ministria Rozeta Hajdari ka thënë se lejet janë pezulluar për import, deponim të lëndës së parë, si dhe për shitjen me shumicë të këtij produkti.

Për pezullimin e lejeve ka thënë se MINT-i është bazuar në fakte, të cilat i ka konstatuar dogana. “Petrol Company’, ‘Kosova Refinery’, ‘Kulla Exim’, ‘In Oil’ janë kompanitë të cilave u janë

pezulluar lejet”, ka thënë ministria Hajdari në një konferencë për medie.

Ndaj këtyre operatorëve ministria Hajdari ka thënë se janë duke u zhvilluar procedura hetimore për cilësinë të derivateve të naftës. Ajo ka bërë me dije se njërit subjekt i është pezulluar edhe leja për importin e vajrave të rënda dhe ndaj tij po zhvillohet procedura hetimore nën dyshimet për mashtrim me cilësi të karburanteve, të cilat subjekti ua ka shitur institucioneve publike. “Gjatë javëve të fundit kemi marrë dhe testuar disa

mostra të dizelit në kazernat e FSK-së. Me Inspektoratin e Tregut kemi gjetur shumë raste të jokonfirmimit. Në një rast kemi gjetur dizel me përmbajtje të sulfurit prej 77.4 mg/kg, që e tejkalon shumëfish shkallën e lejuar prej 10 mg/kg. Për këto raste do ta njoftojmë edhe prokurorinë”, ka theksuar Hajdari.

Ajo ka shtuar se në bashkëpunim me Doganën dhe Administratën Tatimore, Inspektorati ka gjetur se një numër i madh i shitësve ka tejkalluar marzhën tregtare të lejuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës.

Nxënësit protestojnë me moton “S’po shkohet në shkollë”

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Mijëra nxënësit në 28 komunat e Kosovës kanë protestuar të martën me moton “S’po shkohet në shkollë”.

Protesta e organizuar nga Këshilli i Nxënësve të Kosovës ka pasur për qëllim kthimin e vëmendjes të procesit mësimor. Kjo kërkesë iu drejtua institucioneve shtetërore, mësimdhënësve, prindërve

dhe nxënësve. “Nuk kemi dritë, ajër të mjaftueshëm. S’kemi siguri në klasë, në oborr dhe në rrugë. Në shkollë s’kemi as psikologë, as shkollë emergjente, as kuti të emergjencës. S’kemi kabinete për praktikë, as salla të edukatës fizike. Në vend të krejt këtyre, kemi substanca narkotike dhe duhan. S’po shkohet në shkollë. Në shkollë

s’kemi as libra. Hala mësojmë përmes diktimit dhe skrimtës. S’po shkohet në shkollë se ato libra që janë, kanë gabime dhe janë të vjetra. Librat diskriminojnë gratë dhe kategori të tjera të marginalizuara. S’po shkohet në shkollë, se shkolla është e mërzitshme”, u tha në një fjalim të nxënësve para Teatrit Kombëtar në Prishtinë.



BQK-ja, pjesë e takimeve pranverore të FMN-së dhe BB-së

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Një delegacion i lartë i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Fehmi Mehmeti, do të marrë pjesë në takimet e rregullta vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore që po mbahen në Uashington të ShBA-së. Këto takime do të mbahen deri më 24 prill. Në takimet që do të mbahen me zyrtarë të lartë të FMN-së dhe të BB-së, delegacioni i lartë i BQK-së do të diskutojë rreth

zhvillimeve të fundit ekonomike, fiskale dhe financiare, si dhe pritjet për vitin 2022.

Në takimet që do të zhvillohen ditët në vijim do të diskutohet edhe për zbatimin e rekomandimeve nga raportet e mëparshme të asistencave teknike si dhe shprehjet e interesit për përkrahje në të ardhmen. Gjithashtu, do të diskutohet edhe rreth perspektivës dhe sfidave për Evropën.

Takimet vjetore të organizuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore mbledhin bankierë qendrorë, ministra të financave dhe të zhvillimit ekonomik, parlamentarë, drejtues të sektorit privat, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile dhe akademike për të diskutuar për çështje me rëndësi globale, përfshirë perspektivën ekonomike botërore, zhdukjen e varfërisë, zhvillimin ekonomik dhe efektivitetin e ndihmës.



Kosova me vetura të vjetra, importi i tyre është afro 10 vjet më i vjetër se në BE

PRISHTINË, 19 PRILL - Që nga 1 janar 2018 të gjitha veturat e kategorisë më të vjetra se 10 vjet dhe ato që nuk kanë motor të standardit "Euro 4" nuk mund të zhdoganohen brenda territorit të Kosovës. Ky vendim ishte marrë për shkak të kufizimeve ligjore në import dhe për ta ruajtur ambientin nga lirimimi i gazrave të makinave. Përcaktim i vjetërsisë merret për bazë viti i parë i regjistrimit i cili duhet të jetë brenda periudhës 01 janar deri 31 dhjetor të vitit 2012.

Në përgjithësi mesatarja e vjetërsisë së veturave që qarkullojnë në Kosovë është 18 vjet, apo rreth 10 vjet më shumë sesa mesatarja e veturave që qarkullojnë brenda Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2019 ishte provuar që të hiqet ky kufizim, por se nuk kishte pasur sukses ky propozim, e që ishte rrëzuar në Kuvendin e Kosovës.

Nga të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) në vendin tonë janë të regjistruara rreth 400 mijë mjete motorike dhe jomotorike apo një rritje prej 11.4-përqindësh se viti paraprak.

"Në vitin 2021 në Kosovë janë të regjistruara 397 935 mjete motorike dhe jomotorike, në raport me vitin 2020 kemi rritje për 11.4 për qind", thotë ASK.



Pjesëmarrjen më të madhe kanë veturat me 322 mijë e 381 automjete, ndjekur nga transportuesit mbi 3.5 tonelata me 27 748 dhe ata nën 3.5 tonelata me 42 mijë e 730 mjete. Makinat e BE-së tani janë

mesatarisht 11.8 vjet të vjetra. Lituania dhe Rumania kanë flotën më të vjetër të makinave, me pothuajse 17 vjet, ndërsa më të rejat mund të gjenden në Luksemburg me 6.7 vjet. Moshën mesatare të automjeteve të

lehta komerciale në BE është 11.9 vjet. Nga katër tregjet kryesore të BE-së, Italia ka flotën më të vjetër të furgonëve me 13.8 vjet, e ndjekur nga Spanja me 13.3 vjet. Për veturat e reja që importohen nga shtetet e Bashkimit Evropian,

që nga zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim në vitin 2016, nuk paguhet taksa doganore, kurse për veturat e përdorura taksa doganore paguhet 9 për qind nga 10 për qind sa ka qenë më herët. (Telegrafi)

Diskutohet për hartimin e nismës legjislative "Projektligji për kriptovaluta"

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 PRILL - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i kryesuar nga Ferat Shala, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës. Në fillim të mbledhjes anëtarët e komisionit kanë diskutuar mbi caktimin e ekspertit për hartimin e nismës legjislative "Projektligji për kriptovaluta", për të cilin është vendosur që nga katër profesionistë të kësaj fushe, të bëhet përzgjedhja e njërit prej tyre. Si rrjedhojë, eksperti i përzgjedhur do të angazhohet

për të punuar në draftligjin e lartcekur.

E pranishme për raportim në këtë mbledhje ishte ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, e cila para anëtarëve të komisionit ka folur për gjendjen dhe administrimin e rezervave shtetërore të mallrave si dhe për "Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport-CERP huamarje nga Banka Botërore". Lidhur me këtë, anëtarët e pranishëm të komisionit kanë diskutuar dhe paraqitur qëndrimet e kanë bërë pyetje mbi mbarëvajtjen e këtij

projekti.

Në këtë mbledhje ministrja Hajdari ka theksuar se ka marrë shumë shantazhe nga mediet. Nuk ka treguar se për çfarë saktësisht, pasi nuk ka sqaruar, por ajo ka thënë se këto "shantazhe" kishin të bënin me trajnime dhe edukime. "Po marrë shantazhe nga mediat, jo trajnime, jo edukimi e të tjera. Nuk janë nënshkruar marrëveshjet në hotelin e lartcekur, por ka qenë një tjetër. Ne kemi trashëguar një ministri ku nuk kemi vend për mbi 130 persona", ka thënë ministrja Hajdari.



Dhjetë zakone të dëmshme, nga të cilat nuk mund të heqim dorë



Njerëzit duket se kanë një oreks për vetë-shkatërrim. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për blerjet e shfrenuara, pirjen e tepërt të alkoolit apo të duhanit, apo hyrjen me vetëdije në marrëdhënie toksike, nevoja jonë e qenësishme për kaos duket se nuk mbaron kurrë.

Por çfarë na nxit ta vendosim veten në rreziqe të tilla? Ka shumë shpjegime shkencore se përse njerëzit janë të prirur drejt sjelljeve vetë-shkatërruese. Një përgjigje e mundshme mund të datojë që nga fëmijëria. Studiuesit kanë zbuluar se traumat e hershme dhe kujdesi prindëror jo i duhur, mund t'i nxitë individët të përfshihen në akte vetë-shkatërruese si një mekanizëm përbalues.

Problemet e shëndetit mendor, ngjarjet që mund të ndryshojnë jetën apo stresi i pakontrollueshëm, mund të çojnë gjithashtu në sjellje të pamatura. Edhe Sigmund Frojdi besonte se të gjithë njerëzit kanë një dëshirë të pandërgjegjshme për të vdekur.

Sipas tij kjo mund të shfaqet nga jashtë në formën e agresionit, dhunës apo edhe vetë-dëmtimit. Ashtu si shumë nga idetë e tjera të Frojdit, kjo teori është shumë e kritikuar sot nga shkencëtarët. Ja cilat janë 10 sjelljet vetë-shkatërruese, me të cilat shumica prej nesh kanë flirtuar të paktën një herë (nëse mos disa herë) në jetën tonë:

Prirja për të qenë të dhunshëm

Nuk është për t'u habitur pse njerëzit tërhiqen nga dhuna. Qoftë në filma, libra apo në internet, duket se kudo

që hedhim sytë, dhuna e dominon jetën tonë. Studimet kanë treguar se dhuna nuk ka të bëjë vetëm me emocionet negative, si zemërimi, që mund ta nxisin atë. Truri ynë i përpunon sjelljet agresive si dhuna, në një mënyrë të ngjashme me mënyrën se si përpunon sjelljet shpërblyese, që do të thotë se është në natyrën e njeriut të zgjedhë zënkën për të kënaqur një dëshirë.

Abuzimi me substancat

Pirja e tepërt e alkoolit, pirja e duhanit, e drogave të ndryshme. Këto mund të jenë disa nga mënyrat më të zakonshme përmes të cilave njerëzit vetë-shkatërrohen. Për më tepër, individët që abuzojnë me substanca, përballen shpesh me një aftësi të reduktuar për të kontrolluar impulset e tyre ndaj alkoolit apo drogës. Kjo mund të çojë në një betejë të vështurë me varësinë, ku nis të dështojë funksioni normal i trurit.

Marrëdhëniet toksike

Ndërprerja e kontaktit me individë toksikë – qoftë ky një mik, anëtar i familjes apo edhe një marrëdhënie romantike – nuk është diçka e lehtë. Shpesh, mohimi i realitetit mund të jetë një pjesë e rëndësishme e arsyes pse dikush mund të qëndrojë në një marrëdhënie jo të shëndetshme. Mohimi vepron si një mekanizëm përbalues, dhe për këtë arsye na pengon të kuptojmë se mund të jemi në një mjedis të dëmshëm.

Ngacmimi i të tjerëve

Nuk është një sekret që ngacmimi

mund t'i lërë individët me trauma të rënda mendore dhe emocionale. E megjithatë 1 në 5 nxënës dhe studentë raportojnë se ngacmohen çdo vit. Dhe shpesh kjo situatë nuk përmirësohet kur njerëzit rriten. Studiuesit kanë zbuluar se gati 30 për qind e punonjësve janë përballur me bullizmin në vendin e punës nga kolegët apo shefat me sjellje agresive. Por çfarë na shtyn të përqeshim të tjerët? Psikologët kanë sugjeruar se akti i ngacmimit pasqyron probleme serioze tek ata që e kryejnë atë, si pasiguritë e një individit dhe nevoja për kontroll.

Stresimi në nivele të pakontrollueshme

Nuk ka asnjë dyshim se stresi mund të ndikojë negativisht në mirëqenien tuaj fizike dhe mendore. Por edhe nëse e dimë këtë, të gjithë jemi vazhdimisht të stresuar. Të gjithë jemi të stresuar për gjërat e mëdha – karrierën, familjen, financat – ndonjëherë edhe për gjërat e vogla, si vonesa në një takim.

Por aktivizimi i vazhdueshëm i hormoneve të stresit mund të ketë reziqe serioze shëndetësore, të cilat me kalimin e kohës nisin ta përkeqësojnë cilësinë e jetës tuaj. Studiuesit kanë zbuluar se stresi kronik mund të kontribuojë edhe në shfaqjen e gjërave të tilla si presioni i lartë i gjakut dhe sëmundjet e zemrës.

Kapërcimi i orëve të gjumit

Është e rëndësishme të pranojmë se mos-fjetja mjaftueshëm çdo natë

mund të jetë e dëmshme për shëndetin tonë. Në fakt, fjetja më pak se 7 orë gjumë në natë mund të ketë një ndikim të qëndrueshëm në shumë zona të trurit tuaj, duke përfshirë vëmendjen dhe përqendrimin, kohën e reagimit, kujtesën dhe vendimmarrjen. Mënyra më e lehtë për të hequr dorë nga ky zakon i keq, është t'i krijoni vetes hapësirë për pushim, dhe të praktikoni një higjienë të mirë të gjumit.

Gënjeshtret e vazhdueshme

Arsyeja pse njerëzit gënjejnë kaq shumë, mbetet ende një mister për psikologët. A e dini se duhet rreth 30 për qind më shumë kohë për të gënjyer sesa për të thënë të vërtetën? Me kalimin e viteve, studiuesit kanë teorizuar se pandershmeria është një pjesë e asaj që na bën njerëz. Kjo ndodh shpeshherë për shkak të interesave egoiste si promovimi në detyrë, mbrojtja e vetvetes, apo edhe mbulimi i gabimeve tona.

Dëshira për të tradhtuar

Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se njerëzit tërhiqen nga aktivitetet që i bëjnë të ndiejnë kënaqësi. Ndërsa çdo situatë është unike, tradhtia mund të jetë kryesisht rezultat i dëshirës tonë të lindur njerëzore për të ndjerë kënaqësi, veçanërisht nëse nuk jemi duke marrë atë në marrëdhëniet tona aktuale. Një studim i vitit 2021 zbuloi 8 arsye kryesore pse tradhtojnë njerëzit, duke përfshirë zemërimin,

vetëvlerësimin dhe nevojën për diversitet.

Varësia nga lojërat e fatit

Ndoshta për këtë dukuri, mund të fajësojmë dëshirën tonë të lindur për të kërkuar shpërblime. Nuk është çudi që gati 80 për qind e të rriturve amerikanë kanë luajtur në lojërat e fatit të paktën një herë në jetën e tyre. Studimet kanë zbuluar se dopamina, një neurotransmetues i fokusuar tek kënaqësia, çlirohet më shpesh kur është i pasigurt shpërblimi i një basti të caktuar.

Mania për të bërë thashetheme

Si krijesa të natyrshme sociale, njerëzit dëshirojnë informacione të reja, dhe thashethemet janë shpesh mënyra se si i marrim ato. Ka thashetheme të mira dhe të këqija. Ndërsa thashethemet e mira përfshijnë përhapjen apo shkëmbimin e informacionit në një mënyrë të përgjegjshme, thashethemet e këqija – përhapja e gënjeshtreve dhe ndarja e informacionit të pasaktë për të tjerët, për të ecur përpara në karrierë apo për t'i shkaktuar dikujt dhimbje – bën të kundërtën dhe mund të jetë e dëmshme për të tjerët, por dhe vetë-shkatërruese.

Megjithatë, nëse e gjeni veten duke u marrë me thashetheme (shpresojmë të padëmshme) me kolegët tuaj, nuk duhet që të ndiheni shumë keq. Shkencëtarët kanë zbuluar se truri është i prirur që të reagojë ndaj thashethemeve.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Sot gjysmëfinalet e Final 4 të Ligës Unike

PRISHTINË, 19 PRILL - Pas përfundimit të edicionit të rregullt dhe çerekfinaleve është koha për Final 4 të Ligës Unike, që do ta përcaktojë kampionin e kësaj gare, apo trofeun më të çmuar. Final 4 do të zhvillohet më 20 dhe 21 prill në "Karagaçi" të Pejës, ku do të takohen Golden Eagle Ylli-Teuta dhe Peja-Prizreni 16.

Kampion është Ylli që, gjithashtu, ka fituar edhe Superkupën Mbarëkombëtare, dy trofetë e vetëm të kësaj gare, që janë mbajtur deri më tani. Ylli kishte përfunduar garat e rregullta me 13 fitore dhe vetëm një humbje. Humbja e vetme ishte pikërisht nga Teuta e Durrësit me rezultat 78:71, por më pas kishin fituar



therandasit 73:59. Durrsakët kishin përfunduar garat në vendin e pestë, më pas në çerekfinale të "play-off"-it mundën Tiranën. Peja dhe Prizreni 16 janë ndeshur dy herë në garat e rregullta në Ligën Unike, ku pejanët shënuan dy fitore. Në elitën e basketbollit të Kosovës janë përballur katër

herë, ku në të gjitha ndeshjet fituan pejanët. "Verdhezinjtë" përfunduan garat e rregullta në vendin e dytë, ndërsa prizrenasit në vendin e tretë dhe në çerekfinale të "play-off"-it kishin mundur Rahovecin. Ndeshjet transmetohen ekskluzivisht në Art Motion dhe Kujtesa.

ORARI

Të mërkurën takohen:

17:00 Golden Eagle Ylli - Teuta
20:30 Peja - Prizreni 16

Të enjten takohen:

17:00 Ndeshja për vendin e tretë
20:30 Finalja

Kuka dhe Kelmendi nderohen me çmimin 'Ditët e Shqipës'

PRISHTINË, 19 PRILL - Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi janë nderuar me një tjetër çmim. Trajneri dhe sportistja më e mirë në histori të Kosovës janë shpërblyer sot me çmimin "Ditët e Shqipës". Ky nder iu bë atyre në Ditën e Veteranëve të betejës së Koshares, ku u vlerësua lart sakrificat e madhe e dëshmorëve në betejën e Koshares. Organizimi u bë nën përkujdesjen e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani dhe ish-Brigadës 138 "Agim Ramadani". Kuka dhe Kelmendi u vlerësuan lart për punën dhe përkushtimin e madh në sport, i cili i solli rezultate të mëdha Kosovës. Atyre çmimin ua dha Rustem Berisha, ish-komandant i kësaj brigade. Me këtë rast, Kuka u shpreh i nderuar me çmimin e marrë. Trajneri pejan shtoi se ai dhe garuesit e tjerë po e ndjekin rrugën e luftëtarëve. Ndërsa Majlinda Kelmendi tha se



ndihet krenare që e ka ngritur lart flamurin shtetëror të Kosovës. Ajo ndihet me fat dhe e nderuar që e pati mundësinë t'ia tregojë botës vlerat që i ka vendi i saj.

Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi ia kanë sjellë Kosovës sukseset më të mëdha në sport, duke fituar medalje të artë olimpike.

SHKURT

Dy medalje për Kosovën në Kampionatin Evropian të Boksit

Dy medalje të bronzta kanë arritur t'i sigurojnë boksierët kosovarë Taulant Jakupi dhe Donat Sylja. Jakupi dhe Sylja patën paraqitje mjaft të mira në kampionat. Në çerekfinale në luftë për medalje në kategorinë 86 kilogramë Taulant Jakupi boksoi kundër boksierit nga Armenia, Aleksanyan Aghvan, ku korri fitore dhe siguroi medaljen e bronzit dhe më 20 prill ai do të boksojë për t'u kualifikuar në finale. Po ashtu, medaljen e bronzit e siguroi në kategorinë 92 kilogramë Donat Sylja, i cili në çerekfinale mundi boksierin nga Moldavia Cojocari Daniel dhe u kualifikua për në gjysmëfinale. Ndërsa boksierja Alnera Brahimi humbi në të tetën e finales kundër boksieres nga Hungaria, Kovacs Nikolett.

Torino e konsideron të paprekshëm Vojvodën

Skuadra e Milanit ka shfaqur interesim për reprezentuesin e Kosovës, Mërgim Vojvoda. Mbrojtësi ka shpërthyer në muajt e fundit, kur edhe është bërë një titullar i padiskutueshëm në skuadrën e Torinos. Mediumi italian "Tuttosport" raporton se Torino nuk e ka ndër mend ta lëshojë lehtë futbollistin. Madje "Granata" po e përgatit një kontratë të re për 27-vjeçarin. Vlera e kartonit të Vojvodës është 10 milionë euro.

Ergyn Ahmeti, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për xhiron e 29 në BKT Superligë i është dhënë futbollistit të KF Dukagjini, Ergyn Ahmeti. Mesfushori qendror i skuadrës nga Klina pati paraqitje të shkëlqyeshme në fitoren që Dukagjini e arriti si mysafir në Skenderaj kundër Drenicës me rezultat 1:0. Ndonëse nuk ishte realizator i golit, ai u shqua me kreativitetin e tij gjatë tërë ndeshjes, duke qenë në vazhdimësi pikënisja e çdo aksioni të rrezikshëm të Dukagjinit dhe ndër më të merituarit për arkëtimin e tri pikëve tejet të rëndësishme në luftën për mbijetesë. Pas fitores në Skenderaj, skuadra e drejtuar nga Armend Dallku edhe më tutje ndodhet në pozitën e tetë, por tani me 33 pikë, me vetëm dy pikë më pak se Drenica në vendin e shtatë. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e KF Dukagjini e dorëzoi Halim Vitija, asistent specialist në Departamentin e Administratës në BKT.

Leclerc: Në Imola me dy objektiva të qartë

IMOLA, 19 PRILL - Këtë fundjavë botërori i Formulës 1 spostohet në pistën e Imolas në Itali. Një fundjavë interesante pasi, përveç garës së të dielës, do të jetë edhe "gara sprint" e së shtunës, ku gjithashtu jepen pikë të rëndësishme për botërorin. Një

fundjavë që pritet me interes dhe padurim nga Ferrari, që këtë sezon kryeson kampionatet për konstruktorë dhe pilotë. "I kisha harruar garat sprint dhe këtë fundjavë do të kemi dy ditë të angazhuara, pasi janë në tavolinë shumë pikë. Do të jetë

një fundjavë e rëndësishme, pasi të gjithë do të synojnë të grumbullojnë sa më shumë pikë, si në 'garën sprint' ashtu edhe në garën e së dielës. Shpresoj që këtë herë të na shkojë mbarë, pasi vjet kishim vështirësi", ka thënë Leclerc. "Nuk e di se si do

të reagojë makina në këto dy gara, në një pistë evropiane si kjo e Imolas. Janë dy javë ku të gjithë kanë punuar fort, ndaj duhet kujdes që nga dita e premte për të pasur një makinë të shpejtë. Uroj të paraqitemi mirë si në tri garat e Formulës 1 para dhe t'u



dhurojmë tifozëve të Ferrarit një fundjavë me fitore të dyfishtë", ka deklaruar Leclerc.

Mbappe dhe Modiqi në listën e lojtarëve që u përfundon kontrata në verë

Paris, 19 prill - Merkato e kësaj vere pritet të jetë shumë e "nxehhtë" me disa nga emrat më të mëdhenj të futbollit evropian që janë në përfundim të kontratave me klubet respektive dhe që ende nuk kanë rinovuar, një pjesë e të cilëve me synim destinacione të reja. Po t'i hedhësh një sy listës me lojtarët që pritet të lëvizin pas qershorit, është e qartë se ka për të pasur një garë shumë të vështirë mes gjigantëve të futbollit. Futbollistët, kontratat e të cilëve mbarojnë në verën e 2022-shit, janë: Kylian Mbappe te Paris Saint-Germain, me francezin i cili është mes dy opsioneve, rinovimit me PSG-në dhe të bëhet lojtari më i paguar ndonjëherë ose bashkimit me skuadrën që e ka ëndërruar që



fëmijë, me Real Madridin. Paul Pogba nuk dëshiron që të jetë më pjesë e Manchester Unitedit. Francezi u bashkua me "Djajtë e Kuq" për një rritje më tej në karrierë, por që rezultoi një dështim për të dhe tashmë mesfushori është duke kërkuar për një përvojë të re, me Juventusin, Real Madridin dhe PSG-në që janë të interesuar për të. Ky sezon nuk mund të konsiderohet më i miri i mundshëm për Iscon dhe tashmë duket se ka ardhur momenti që rrugët e tij me Realin të ndahen. Mesfushori nuk ka gjetur hapësirat e dëshiruara gjatë këtij sezoni dhe momentalisht është duke parë për mundësi të reja për të ardhmen. Luis

Suarezi është një tjetër emër që do të jetë i lirë në këtë verë. Kontrata e uruguait me Atletico Madridin është në javën e fundit dhe duket se, pavarësisht dëshirës së klubit spanjoll për të rinovuar me 35-vjeçarin, ky i fundit po i analizon me kujdes alternativat që ka, mes tyre është edhe opsioni i kalimit në Amerikë. Real Madridi mund ta humbasë edhe Luka Modriqin. Kroati është një nga emrat kryesor te skuadra madriline, megjithatë palët ende nuk kanë rinovuar kontratën, e cila përfundon këtë verë, pavarësisht se në deklaratat e tyre kanë theksuar se dëshirojnë vazhdimësinë.

Lista me lojtarët që u përfundon kontrata këtë verë:

Angel Di Maria	(Paris Saint-Germain)
Gareth Bale	(Real Madrid)
Andre Onana	(Ajax)
Antonio Rudiger	(Chelsea)
Jesse Lingard	(Manchester United)
Alexandre Lacazette	(Arsenal)
Andreas Christensen	(Chelsea)
Ousmane Dembele	(Barcelona)
Divock Origi	(Liverpool)
Cesar Azpilicueta	(Chelsea)
Marcelo	(Real Madrid)
Zlatan Ibrahimović	(Milan)
Andrea Belotti	(Torino)
Paulo Dybala	(Juventus)
Franck Kessie	(Milan)
Ivan Perisic	(Inter)
Alessio Romagnoli	(Milan)
Thomas Strakosha	(Lazio)

Philadelphia dhe Golden State fitojnë edhe sfidat e dyta

PHILADELPHIA, 19 PRILL - Kanë nisur ndeshjet e dyta çerekfinale të "play-off"-it në NBA. Në Lindje, skuadra e Philadelphia's udhëheq 2-0 serinë e

takimeve ndaj Torontos, duke fituar me rezultat 112-97. Të gjithë titullarët e Philadelphia's realizuan mbi 10 pikë, Embiid, autor i 31 pikëve dhe Maxey, 23 pikë. Për kanadezët u dallua Anunoby me 26 pikë. Po ashtu 2-0 udhëheq serinë e ndeshjeve edhe skuadra e Golden States, që e mposhti Denverin (126-106). Sfidë e komanduar nga skuadra e Warriorsit, ku u dallua Curry me 34 pikë. Ai e nisi ndeshjen nga stoli, por tregoi se është gjithnjë lider, mbështetur edhe nga Poole me 29 pikë. 26 pikët e Jokiqit për Denverin mbetën për statistikë. Barazim 1-1 me ndeshje mes Dallasit e Utah Jazzit. Skuadra teksane fitoi me



rezultat 110-104 ndaj Jazzit, në një duel të ekuilibruar përgjatë gjithë kohës. Mitchell realizoi 34 pikë e Bogdanoviçiqi 25, por që s'mjaftuan për miqtë. Në kahun tjetër, Brunsoni me 41 pikë ishte i magjishëm në parket për Dallasin.

Konferenca e Lindjes - Çerekfinale "play-off"

Miami - Atlanta	(1-0)
Philadelphia - Toronto	112-97 (2-0)
Milwaukee - Chicago	(1-0)
Boston - Brooklyn	(1-0)

Konferenca e Perëndimit - Çerekfinale "play-off"

Phoenix - New Orleans	(1-0)
Dallas - Utah Jazz	110-104 (1-1)
Golden State - Denver	126-106 (2-0)
Memphis - Minnesota	(1-0)

Neymar: Jam i lodhur nga këta ish-futbollistët që hapin gojën vetëm për kritika

Ish-futbollisti i Liverpool, Fabio Aurelio foli me shumë kritika së fundmi për atë që Neymar ka treguar gjatë eksperiencës me PSG-në. Ish-mbrojtësi theksoi se

braziliani duhej të kishte një nivel më të lartë në fushë dhe deri në këtë moshë të kishte fituar të paktën një herë "Topin e Artë". Megjithatë, nuk ka munguar as

kundërpërgjigja e brazilianit e cila në fakt ka qenë e ashpër. Në rjetet sociale, fantazisti i PSG-së shprehur se tashmë është i lodhur nga ish-futbollistët të cilët

vetëm kritikojnë kur flasin. "Jam i lodhur nga këta ish-futbollistët që hapin gojën vetëm për kritika. Ishte një intervistë pesëminutëshe dhe gjithçka bëri

ai ishte të merrej me jetën e të tjerëve, nuk po them të mos kritikosh, por nuk është mirë të flasësh në këtë mënyrë", ka thënë Neymar.

SHKURT

Fazliji e Kryeziu në formacionin e javës në Zvicër

Superliga e Zvicrës ka publikuar formacionin për javën e 30-të. Në skemën 3-4-3, janë futur edhe dy lojtarë shqiptarë që kishin paraqitje të mira. Zurich triumfoi ndaj Young Boys me rezultat 2-1, ndërsa Mirind Kryeziu luajti për 90 minuta të plotë. Kjo është hera e pestë që Kryeziu futet në formacionin e javës në elitën e futbollit zviceran. Në anën tjetër, St. Gallen u mposht nga Luzerni me rezultat të ngushtë 3-2, ndërsa Betim Fazliji ia doli të realizonte një gol të bukur. Kështu, ai ia doli po ashtu të futej në formacionin e javës dhe është hera e parë për të.

City arrin marrëveshje me Haalandin

Manchester City ka arritur një marrëveshje me Erling Haaland. Këtë gjë e raporton "Daily Mail", e cila bën me dije se bomberit norvegjez ka pranuar nëpërmjet agentëve të tij, kushtet e kontratës së propozuar nga klubi anglez që do t'i garantonte atij një pagë prej 600 mijë euro neto në javë, e cila do ta bënte atë lojtarin më të paguar të Premier Ligës.

Bayerni për 40 milionë euro heq dorë nga Lewandowski

Sulmuesi Robert Lewandowski vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes, me të ardhmen e tij që vazhdon të jetë në pikëpyetje. Ylli polak po shkon drejt muajve të fundit të kontratës së tij me Bayern Munchen dhe mund të largohet nga 'Allianz Arena' qysh gjatë kësaj vere. Skuadra e Barcelonës është ajo që ka shfaqur interesimin më të madh për shërbimet e Lewas. Sipas "Kicker", Bayerni kanë filluar të zbusin qëndrimet dhe tashmë kanë caktuar një çmim. 40 milionë euro për të liruar kartonin e Lewandowski gjatë kësaj vere. Mbetet të shihet se cili do të jetë hapi i Barcelonës. Kontrata e Lewandowski me Bayern skadon në vitin 2023.

Romagnoli, afër kalimit te Lazio

Transferimi i Alessio Romagnolit te Lazio duket një çështje e mbyllur. Negociatat po ecin në rrugën e duhur dhe së fundmi janë gjetur edhe marrëveshjet për detajet e vogla që e mbanin pezull. E vetmja gjë që mungon tashmë është vetëm zyrtarizimi, por sipas të njëjtit burim ka edhe një datë se kur pritet të vijë komunikata e klubit. Alessio Romagnoli me Milanin e tij do të përballet më 24 prill me Lazio në një ndeshje që pritet të jetë shumë vendimtare për titullin kampion. Pas kësaj ndeshjeje pritet të vijë edhe zyrtarizimi për kalimi e tij te klubi "bardhekaltër".



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +383(0)390/321 588
+383(0)390/324 034
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nën 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr. 59 me Nr. Protokollin 644 i datës 19.04.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv, u vendos që me datë 20.04.2022 të shpallet :

Konkurs publik

Për këto pozita:

I. SHOFER ME KATEGORI "B" me kohë të caktuar, me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

Numri : 1/një/

I përgjigjet: Koordinatorit të Autoparkut në Operativës.

Vendi: Gjakovë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kushtet e përgjithshme:

1. Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme,
2. Të ketë më së paku 1 (një) vit përvojë të punës.

Kushtet e veçanta:

1. Të posedoj patentë shofer me kategori "B",
2. Të mos jetë i dënuar apo nën hetime,
3. Preferohet të ketë njohuri të punës dhe ngasjes/manipulimit/ me ekskavator.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma, Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, Patentë Shoferi me kategori "B", Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar (më i re se gjashtë muaj), Dëshmia për njohurit e punës dhe ngasje-manipulim me ekskavator, dhe Letër Njoftimi.

II. PUNËTORË FIZIK SEZONAL, me kohë të caktuar, me mundësi vazhdimi.

Numri : 4/katër/

I përgjigjet: Menaxherit të Operativës.

Vendi: Gjakovë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë përgatitje- Shkollim Fillor i preferueshëm;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune;

Kushtet e veçanta:

- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore,
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

Kandidatet duhet t'i dorëzojnë këto dëshmi:

Aplikacionin, CV-në, Dëshminë e shkollimit, Dëshminë për përvojën e punës, Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj), Certifikata e mjekut- preferohet.

Detyrat e punëve : për këto dy pozita mund t'i gjeni në Web faqen e kompanisë: cabrati.com

Paga për këto dy pozita: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Afati i paraqitjes së kërkesave për këto pozita është nga dita e publikimit, dhe atë nga data 20.04.2022 e deri me datë 04.05.2022 në ora 16:00.

Kërkesën me dokumentacionet e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek zyra e Menaxherit të Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës pozitive Nr. I, kurse për pozitive Nr. II vetëm intervistë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "BROWNS" L.L.C me seli në Prishtinë me nr. biznesit: 810840125, ka marrë vendim të shuajë biznesin dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo "BROWNS" L.L.C iz Prishtine sa biznesom brojem; 810840125, donelo odluku o prestani rada ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "BROWNS" L.L.C in Prishtina business number; 810840125. has come to the decision to quit its business has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ilir Bajrakçari shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga kl. I deri VIII.

► Shqipe Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.U. "Luigj Gurakuqi" Korenicë KK Gjakovë nga kl. VI-IX.

► Eroll Cana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, të Gjinnazit "Hajdar Dushi".

► Mejreme Musaj nga Skivjani KK. Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Ukshin Miftari" nga KL. I-VIII.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit administrativ nr. 05/2021, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe kërkesave të Qendrës Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, shpall:

KONKURS

Për vendet e lira të punës në Qendrat Burimore për Mësim dhe Këshillim

Nr.	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	Instruktur/e i gjuhës së shenjave në QB "Nënë Tereza" në Prizren	vend i lirë	1
2	Motër konviktore në QB "Lef Nosi" në Prizren	vend i lirë	1

I. Punët dhe detyrat kryesore të instruktorit/es së gjuhës së shenjave

- Mbështet nxënësit dhe stafin e QB për gjuhën e shenjave;
- Ofron kurse të gjuhës së shenjave për stafin e QB dhe prindërit e nxënësve;
- Bashkëpunon me menaxherin dhe stafin e QB në promovimin e gjuhës së shenjave;
- Në bashkëpunim me stafin harton materiale për QB në gjuhën e shenjave.

1. Përgatitja shkollore për instruktor/e të gjuhës së shenjave

- Niveli baçelor – trajnimi për gjuhën e shenjave me 120 kredi (ECTS).

II. Punët dhe detyrat kryesore të motrës konviktore

- Identifikon nxënësit në aspektin shëndetësor dhe në rast nevojë bën rekomandim për në institucionet shëndetësore;
- Përcjell gjendjen shëndetësore të nxënësve brenda qendrës burimore;
- Jep terapinë mjekësore nxënësve sipas diagnozës dhe rekomandimit të mjekut;
- Ndërmerr masa preventive dhe sanitare në lidhje me pastërtinë e nxënësve (kontrollimi i flokëve, pastërtinë e përgjithshme etj.);
- Mban evidencë për shërbimet shëndetësore që iu ofron nxënësve;
- Këshillon nxënësit individualisht dhe në grup për shëndetin dhe higjienën;
- Shoqëron nxënësit në kohën e ushqimit dhe kujdeset gjatë kohës së ushqimit.

2. Përgatitja shkollore e motrës konviktore

- Shkolla e mesme – mjekësi e përgjithshme;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi infermieri;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi pediatri;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – asistent infermier.

Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: paragrafi 5 i nenit 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, paragrafët 5 dhe 7 të nenit 8 të Udhëzimit administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Sqarim shtesë: – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Formulari i aplikimit (merret në Qendër Burimore).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar. Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë.

Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Na osnovu člana 67 i 68 Zakona br. 06 / L-114 o javnim službenicima član 8 stav 1 i 2 Zakona o radu br. 03/L-212, (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 90/2010), Zakon br. /L-032 o predniverzitetkom obrazovanju u Republici Kosovo, Administrativno uputstvo br. Br. 05/2021, Administrativno uputstvo 02/2018 o Resursnim centrima, Administrativno uputstvo br. 07/2017 o regulisanju procedure konkurisanja u javnom sektoru i zahtevima Resorsnih centra, Departament za preduniverzitetko obrazovanje objavljuje;

KONKURS

Konkurs za slobodna radna mesta u Resorsnim centrima za nastavu i savetovanje

Br.	Položaj:	Slobodno radno mesto/zamena	Br. pozicija
1	Instruktur znakovnog jezika u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	1
2	Sestra u dom za stanovanje u RC "Lef Nosi" u Prizren	slobodno radno mesto	1

I. Glavni zadaci i obaveze Instruktor/ke znakovnog jezika:

- Podržava učenike i osoblje RC u znakovnom jeziku;
- Omogućava kurseve znakovnog jezika za osoblje RC i roditelje učenika;
- Saraduje sa menadžerom i osobljem RC u promociji znakovnog jezika;
- U saradnji sa osobljem sastavlja materijale za RC na znakovnom jeziku.

1. Školska sprema za Instruktor znakovnog jezika

- Nivo bachelor – obuka znakovnog jezika sa 120 kredita (ECTS).

II. Glavni zadaci i obaveze sestre u domu za stanovanje

- Identifikuje učenike sa aspekta zdravlja i prema potrebi daje preporuke zdravstvenim ustanovama;
- Prati zdravstveno stanje učenika unutar resursnog centra
- Daje medicinsku terapiju učenicima prema dijagnozi i preporuci lekara;
- Poduzima preventivne i sanitarne mere u vezi čistoće učenika (kontrola kose, opšta higijena, itd.);
- Voditi evidenciju o zdravstvenim uslugama koje se nude učenicima;
- Savetuje učenike pojedinačno i u grupama o zdravlju i higijeni;
- Prati učenike u vreme obroka i stara se o njima za vreme obroka;

2. Školska sprema seste vaspitačice u dom

- Srednja škola - opšta medicinska;
- Srednja medicinska škola – smer infermjerstvo;
- Srednja medicinska škola – smer pedijatrija;
- Srednja medicinska škola – asistent inferijera.

Uslovi konkursa

Izbor kandidata vrši se na osnovu kriterijuma zakona koji regulišu oblast obrazovanja: stav 5. člana 35. Zakona br. 04 / L-032 o preduniverzitetkom obrazovanju u Republici Kosovo, stav 5 i 7 člana 8 Administrativnog uputstva 05/2021 o Normativu stručnog kadra opšteg obrazovanja.

Dodatno pojašnjenje: -Informacije prikazane u aplikaciji smatraju se validnim samo u koliko budu potkrepljeni dokazom

Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju dostaviti da je izvršena nostrifikacija dokumenta od strane MONTI-a.

Na pismenom intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa.

Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objave konkursa u medijima javnog informisanja.


Formulara za aplikaciju (može se dobiti u Resornom Centru).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).


Diploma kvalifikacije (ili certifikat) certifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Kandidati, dokumenta trebaju predati u relevantni Resursni centar / Specijalnu školu u kojoj konkurišu.

Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.473 datë 19.04.2022

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm),UA MASHTnr.08/2021,Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

- SHFMU"Vaso Pashë Shkodrani"-Leshan**
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e historisë
 - Koeficienti: A-421
- SHFMU"Besim Ndrecaj "në Maqitevë**
 - Një punëtor/e teknik-ndihmës
 - Koeficienti: A-4/1
- SHFMU"Flamuri i Arbrit "në Reshtan**
 - Një punëtor/e teknik-ndihmës
 - Koeficienti: A-4/1


Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:


- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkollës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës ,duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit,Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.


Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani



SHKOLLA E MESME LARTË
"Luciano Motroni"
Nr.Prot. 414 dt.19.04.2022
PRIZREN
Tel: 038 20035380;038 20035379
E-mail: shmlmlucianomotroni@hotmail.com

Mbështetur në UA Nr.02/2016, të datës 12.01.2016,neni 11,paragrafi 2.14,kritereve nga shtojcat 1-5 te nenit 16 te ketij udhezimi, për aktivitetet jashtëshkollore-,me pëlqimin e prindërve të nxënësve maturantë,plani vjetor të drejtorisë së shkollës,me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës date19.04.2022,SHMLM"Luciano Motroni"Prizren,shpall:

FTESE PËR OFRTE

Për ekskursion në Republiken e Shqipërisë për maturantët e SHMLM"Luciano Motroni"në Prizren

Frojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur,për ekskurzionin e maturantëve të SH.M.L.M"Luciano Motroni" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë

Agjensioni turistik duhet t'i plotësojë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme:

- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Licencën e transportit ndërkombëtar D
- Certifikatat e autobusëve sipas licensës D
- Referencat rreth organizmit të ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit 2017, 2018, 2019
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli teknik
- Kopjen e sigurimit të autobusëve, Patentshoferëve të vozitësve dhe Certifikata e kompetecës Profesional CPC.
- Certifikatat mjekesore për vozitësit
- Autobusët të jenë në pronësi, komfor me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për mbi 400 vende
- Kompania të sigurojë mjekun (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut).
- Licencën e agjensionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve
- Dëshmi për hotelin e ofruar në Durrës për datat 16.05.2022 deri me 20.05.2022.
- Të prezantohet ambienti (komoditeti)se paku me foto i hotelit, numri i tel i pronarit dhe adresa.
- Hoteli të posedojë mbi 400 shtretër, të posedojë banjo dhe ujë të mjaftueshëm.
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës.
- Të prezantohet menyuja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për 5 ditë qëndrimi.
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa hyrëse te behet nga AT sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH.
- Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2019,2020,2021)se paku 200.000.
- Hoteli të posedojë sallë për argetim për nxenes dhe te mos sherbehen apo lejoje shitjen dhe perdorimin e pijeve alkoolike në tere hapsiren e hotelit.
- Licensen e salles për argetim për se paku 400 nxenes.
- Oferta për nxenes te liruara nga pagesa.

Vërejtje: Kompania Turistike fituese ne perfundim te ekskurzionit duhet ti siguroje nenskrimet nga :U.D.I Drejtorit te Shkolles,Përfaqësuesi i Keshillit te prinderve si dhe nga Përfaqësuesi i keshillit te nxenesve, per permbushjen e kushteve te percaktuara sipas kriterëve të lartcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

PERMBUSHJA E OBLIGIMEVE NGA Aagjensioni Turistik PARA DHENIES SE KONTRATES.


- Vertetimin e Administrates Tatimore-të dorëzohen para dhenies se kontrates.
- Vertetimi i taksave komunale per vitin 2021 -të dorëzohen para dhenies se kontrates.
- P.s Lartësia e pagesës 120€.

Ofertuesit e interesuar aplikojnë dhe itinerarin e udhëtimit mund ti marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit ne prizren


Afati i paraqitjes në tender është nga 20.04.2022 deri me 28.04.2022 deri në ora 14:00 po ne te njejtën dite behet edhe hapja e ofertave ne ora 15.00 ne DKA Prizren .

Hapjen e ofertave e ben komisioni sipas Udhëzimit Administrativ me nr. 02/2016 të datës 12.01.2016. Përparsi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë agjensionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotësojnë kriteret e caktuara nga KDSH-ja. Kriter për përzgjedhjen e kompanis turistike do të jetë oferta me e lire dhe dokumentacioni i kompletuar.

Drejtoria e shkolles mban të drejten për anulimin e ofertës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br. 473 od 19.04.2022 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068,AI br.05/2021(Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja),UA.MONT-a br.08/2021, Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru,Opština direkcija za obrazovanje objavljuj:

KONKURS
Za popunu slobodnih radna mesta


- OSNSŠ" Vaso Pashë Shkodrani"-Lešane**
 - Jedan nastavnik/ca za predmet Istorije
 - Koeficienta : A-421
- ONSSŠ " Besim Ndrecaj"-Mačitevo**
 - Jedan tehnički / pomoćni radnik
 - Koeficienta:A-4
- ONSSŠ " Flamuri i Arbrit"-Reštane**
 - Jedan tehnički / pomoćni radnik
 - Koeficienta:A-4


Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
- Ekstrakt rođenja
- Ilična karta (fotokopija)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
- Dokaz da nije pod istragom
- Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju(ako ga ima)
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano,dok će se originalni dokumenti podstavljavati u intervju.Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka. Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15(petnaest)dana od obavljenu u novinama.Orasporedu intervju bičete obavešteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.


Direktor profslete
Remzi Bajselmani



Prishtinë, 20.04.2022

NJOFTIM PUBLIK


Shoqëria „2 KORRIKU “ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810305038 me adresë: „Soponicë“ pn Kaçanik, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC SOPONICA me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW ZK Soponica, Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.

Aplikuesi shoqëria „2 KORRIKU “ SH.P.K., për projektin HC SOPONICA me kapacitet të instaluar prej 3.75 MW, ZK Soponica, Komuna e Kaçanikut, me rastin e aplikimit ka dorëzuar në ZRRE edhe dëshmitë shtyllë për marrje të AUTORIZIMT FINAL siç janë:

- Pëlqimi Mjedisor Nr. 4268/20 dt. 29.01.2021 të lëshuar nga Ministria e Ambientit,
- Vendimin nr. 3477-2/20 dt. 21.09.20 (mbi themelimin e servitutit të instalimit të Tubacionit nëntokësorë të HC-së, në pasuri publike ujore),
- Ndryshimi i vendimit për Leje Ujore Nr. 1857-2/18 dt. 12.10.1018 të lëshuar nga Ministria e Ambientit,
- Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 513 dt. 25.01.2022,
- Njoftimin Nr. 06-104/02-35113/19 dt. 29.11.2019 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Kaçanikut,
- Pëlqimin e Komisionit nr. 06-350/01-4745/20 dt. 29.04.2022 të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut,
- Pëlqimin Nr. 01/2021 dt. 02.02.2021 të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, dhe
- Vendimin për Leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit 06 Nr.351/02-27108/21 dt. 30.09.2021 të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut.

Aplikuesi me rastin e aplikimit ka dorëzuar edhe kërkesës formale për tu përfshirë në kornizën rregullative sipas dispozitave ligjore të Rregullës për Skemën Mbështetëse.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.


Direktor profslete
Remzi Bajselmani



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

